



VENDIM

Nr.118 Datë 18.11.2011

**PËR FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT
TË CEZ SHPERNDARJE SH.A PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PERIUDHEN E TRETE RREGULLATORE 2012-2014.**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë Cez Shperndarje sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin Planit të Investimeve të Cez Shperndarje sha për periudhen e trete Rregullatore 2012-2014.

Konstatoi se:

Aplikimi i Cez Shperndarje sh.a për planin e investimeve për periudhen e trete Rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të Cez Shperndarje sh.a për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011 per periudhen e trete Rregullatore 2012-2014.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e Cez Shperndarje sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI